



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 27.02.2023

Nr: 14

Ora: 13:30

VENDIM I NDËRMJETËM

**PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE NR. 5 DHE NR. 8, DATË 17.02.2023
TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 27.02.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 5 dhe 8, datë 17.02.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 27.02.2023 Nr: 14
Ora: 13:30



Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 5 dhe nr. 8, datë 17.02.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 05 regj., datë 17.02.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 08 regj., datë 17.02.2023.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 27.02.2023, me vendimet nr. 8 dhe nr. 11, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ në datën 17.02.2023. Relatorët e kërkesave ankimore përkatësisht z. Koli Bele dhe z. Elvis Çefa kakonstatuan se, të dy kërkesat kishin të njëjtin objekt: Vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës, për mosraportim të veprimtarive publike brenda afatit ligjor.

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave nr. 5 dhe nr. 8 të paraqitura nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datë 17.02.2023 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 5, datë 17.02.2023 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 8, datë 17.02.2023, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Koli Bele.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 5, datë 17.02.2023 dhe nr. 8, datë 27.02.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 28.02.2023 ora 12:30;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**